



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01 - Nr. 16-37268 /15
Kaçanik, 30. 10..2015

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) të Ligjit Nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) duke iu referuar Strategjisë Kombëtare për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar në Kosovë të vitit 2014, si dhe Rregullores (QRK) Nr. 08/2015, për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Menaxhimin e Programit të Riintegritimit, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 30 tetor 2015, mori këtë :

V E N D I M
PËR APROVIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR RIINTEGRIMIN E PERSONAVE TË
RIATDHESUAR NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Veprimit 01Nr. 16-37268/15, për Riintegrimin e personave të riatdhesuar në Komunën e Kaçanikut.
2. Në Planin e Veprimit për Riintegrim, si në pikën 1. të këtij Vendimi, janë paraqitur objektivat, veprimet që do t'i marrin organet përgjegjëse për zbatimin e tyre në periudhat e caktuara kohore, në bazë të dokumenteve referuese të paraqitura si në këtë plan.
3. Plani i Veprimit për Riintegrimin e personave të riatdhesuar, është hartuar nga Grupi punues i formuar me Vendim të Kryetarit të Komunës, është përmbledhur në gjithsej 9 faqe, dhe i njëjti është pjesë përbërse e këtij Vendimi.
4. Ky vendim pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të autoritetit mbikqyrës-MAPL, si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të komunës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen, Kryetari i Komunës dhe organet tjera relevante të përcaktuar si në Planin e Veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar.

Me këtë Vendim, njoftohen:

1. Zyra e Kryetarit të Komunës / përmes saj njoftohen; zyrtarët tjerë përgjegjës-zbatues të Planit të Veprimit për Riintegrim të personave të riatdhesuar,
2. MAPL,
3. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, dhe
4. Arkivi.

Kryesuesi i kuvendit,
Xhelal Gashi

